



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr.102

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Prishtinë, më 5 nëntor 2024, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Mirsad Shkreta, Burim Meta dhe Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

Munguan: Haxhi Avdyli, Bekim Haxhiu, Floretë Zejnullahu dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjenca dhe Katastrofa (CEMEC).

Stafi mbështetës: Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

Pjesëmarrës tjerë: Admir Duraj nga Fondacioni “HOPES”, Violeta Salihu- Emini nga KSHMS-ja .

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takimi me prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjenca dhe Katastrofa (CEMEC);
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Takimi me prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjenca dhe Katastrofa (CEMEC)

Fatmire Kollçaku, tha se në këtë mbledhje, është i pranishëm prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës së Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjenca dhe Katastrofa (CEMEC), i dëshiroi mirëseardhje dhe e falënderoi atë për gatishmërinë për ta ndihmuar Kosovën në sektorin për Mjekësinë në Emergjenca dhe Katastrofa. Ajo tha se ky takim është në kuadër të projektit të

Bashkimit Evropian: “Përmirësimi i qeverisjes parlamentare në Kosovë”, i zbatuar nga Fondacioni “HOPES”, që në mes tjerash, po kontribuon për forcimin e komunikimit ndërmjet organizatave ndërkombëtare, sot para Komisionit, do të na prezantojë qëllimin, rolin dhe veprimtarinë e Qendrës së Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC). Ajo potencoi se ky takim është një mundësi e madhe për t’u njohur me përvojën e madhe që e ka Qendra e Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC), se si edhe Kosova mund të përfitojë nga këto përvoja, për t’i menaxhuar situatat emergjente, katastrofa natyrore, siç ishte rasti edhe përgjatë periudhës me pandeminë COVID-19. Andaj, edhe ky takim është i mirëseardhur dhe një mundësi e jashtëzakonshme dhe e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave me shtetet e BE-së, që kanë provoja shumë më të mëdha në situata të emergjencave dhe katastrofave.

Prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa, (CEMEC), më pas, prezantoi para deputetëve të Komisionit përvojën dhe rëndësinë e punës së Qendrës së Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC). Ai ndër të tjera, tha se CEMEC, në fokus ka bashkëpunimin në fushën e emergjencave natyrore dhe industriale, si dhe të shëndetit publik. Ai tha se për menaxhimin e situatave në emergjencë dhe katastrofa duhet të fokusohen në katër shtylla: hulumtim, trajnim, edukim dhe ndarje të diturive. Qasja për një tranzicion gjithëpërfshirës drejt menaxhimit më të mirë të rrezikut, veçanërisht, në shtete të vogla, si Kosova, duhet të fokusohet në qeverisjen, ndërtimin e kapaciteteve, trajnimin, bashkëpunimin teknik dhe shkëmbimin e njohurive dhe informacionit. Prandaj, misioni dhe ekspertiza e CEMEC është e duhur, për të mbrojtur shëndetin publik. Jam në Kosovë në vendin tuaj, për të ndarë me juve aktivitetin tonë, lidhur me bashkëpunimin me juve për mjekësinë në emergjencë dhe katastrofa dhe me mjedisin shëndetësor të Kosovës. Qendra jonë ka qenë rrjeti i parë që është marrë me shëndetin publik. Aktivitetet kryesore të qendrës sonë janë hulumtimi, trajnimi, edukimi dhe ndarja e diturive. Ne e kuptojmë që ka një nevojë të madhe për të mbrojtur shëndetin publik për shkak të rritjes së shfaqjeve të sëmundjeve ngjitëse të faktorit njeri. Kur kemi ndryshime të mëdha klimatike, në gjithë botën, dihet mirë se cilat janë efektet e tyre, globalizimi, konfliktet, migrimet, të gjitha këto janë elemente të lidhur në nevojën për të mbrojtur shëndetin e publikut. Stuhitë më të reshura të shumta të shiut, zjarret pyjore këto janë katastrofa që shkaktojnë ndotje në natyrë dhe që janë element kryesor për t’i ardhura në ndihmë popullatës. “Migracioni dhe konfliktet janë fjalë tjera kyçe për të ardhmen. Kur flitet për emigrimin, sidomos Italia, që përballet më së shumti me emigracionin ilegal nga zonat e luftës që po zhvillohen nëpër botë. Ballkani është në situatë të ngjashme. Në anën tjetër, në zona konfliktet po shtohen në botë”. Për këtë arsye mjekësia duhet të zhvillojë më shumë në aspektin e emergjencave për ruajtjen e shëndetit publik për t’i parandaluar katastrofat humanitare. Në rast emergjent, së pari duhet të njoftohet publiku se si të reagojë në 10 deri 20- minutëshin e parë të rasteve. Prandaj, duhet të mësojmë edhe publikun se si të reagojnë në 10-20 minutat e parë. Ai shpалosi përvojën e shtetit të Italisë, lidhur me pandeminë COVID-19, më kujtohet faza e parë, sidomos në Itali. Ne kemi pasur pikëpyetje të madhe në atë kohë, kemi pasur shumë njerëz të infektuar, por edhe mjetet elementare, siç janë maskat për ta parandaluar përhapjen e pandemisë me COVID -19, kanë qenë në numër shumë të vogël dhe lëvizjet e kufizuara. Çdoherë e më tepër kemi për të angazhuar dhe mësuar, së pari si ta mbrojmë veten dhe pastaj t’i ndihmojmë të tjerët, maksimumi brenda 30 minutave, në raste të katastrofave natyrore, duhet të bëhet ofrimi i ndihmës emergjente.

Admir Duraj, drejtues teknik i projektit Qendra për Studime Parlamentare të Aplikuara nga Fondacioni “HOPES”, foli për qëllimin e takimit në kuadrin e avancimit të bashkëpunimit dhe partneritetit të institucioneve publike të Kosovës me institucionet homologe, organizatat dhe me agjencitë e specializuara në Evropë. Projekti i Bashkimit Evropian: “Përmirësimi i qeverisjes parlamentare në Kosovë”, i zbatuar nga Fondacioni “HOPES” në Bruksel, po punon për forcimin

e komunikimit ndërmjet institucioneve, përafrimin me norma, standarde dhe praktika që përmirësojnë qeverisjen, politikat publike dhe legjislacionin, si dhe ndihmojnë në qëndrueshmërinë e tyre në shërbim të të gjithë qytetarëve. Në lidhje me këtë qëllim, prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC), në kuadër të vizitës në Kosovë, ka shprehur vullnetin për t'iu prezantuar deputetëve të Komisionit tuaj parlamentar qëllimin, rolin dhe veprimtarinë e Qendrës së Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC), si dhe disa konsiderata të dobishme për Kuvendin në miratimin e legjislacionit në përputhje me Marrëveshjen Evropiane për rreziqet kryesore.

Armend Zemaj, tha se ky takim është i mirëseardhur për fushëveprimin që e mbulon Komisioni, në aspektin e shkëmbimit të përvojave në fushën e emergjencave dhe katastrofave nga Qendra e Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC). Në këtë drejtim, ne si shtet i ri në konsolidimin e institucioneve të reja të kësaj fushe, kemi nevojë për përkrahje të vazhdueshme. Pyeti: Cilat janë mundësitë që edhe Kosova të bëhet anëtare e kësaj organizate “Qendrës së Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC)”, ndërsa nuk jemi anëtar të Këshillit të Evropës? A mund të përfshihen agjencitë e emergjencave të Kosovës, në pjesën e trajnimit të stafit të tyre, përderisa nuk jemi ende anëtar i pranuar i KE-së? Ne e kemi pasur një përvojë të mirë të menaxhimit më pandeminë COVID-19, dhe mund t'i ndajmë këto përvoja në bashkëpunim me ju, si urë lidhëse që udhëhiqeni Qendrën e Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC).

Prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC), tha se është e kuptueshme se çdo vend i ka vështirësitë e veta, me specifikat dhe problemet që rrethojnë. Sipas përvojës, është mirë që të jeni pjesë e trajnimeve dhe ushtrimeve në kuadër të agjencive për emergjencë, që keni dhe mund t'i ndajmë me këto agjenci, përvojat tona. Sa i përket bashkëpunimit, ne si qendër, kemi marrëveshje edhe me vendet që nuk janë pjesë e Këshillit të Evropës. Me ju si shtet, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë në këto fusha, që i mbulon Qendra e Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC).

Labinoçi Demi-Murtezi, e falënderoi prof. Roberto Mugavero, për vizitën që po i bën Kosovës, e posaçërisht për prezantimin që e beri para anëtarëve të Komisionit për qëllimin, rolin dhe veprimtarinë e Qendrës së Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC). Ajo potencoi se edhe pse Kosova ende nuk është shtet anëtar i Këshillit të Evropës, ky takim është për t'iu përgëzuar dhe bashkëpunimi në të ardhmen është i mirëseardhur që të fillojë një urë lidhëse në mes të Kosovës dhe institucioneve përkatëse, që merren drejtpërdrejt me emergjencë dhe katastrofa, në qendrën që drejtoni ju. Pyeti: Cilat janë sfidat në situatat emergjente dhe cila është mesatarja e ruajtëse se shëndetit mendor në këto raste dhe rrethana?

Prof. Roberto Mugavero, president i Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC), tha se në kohën e pandemisë me COVID -19, është dashur që të balancohet ruajtja e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe kufizimi i mospërhapjes së sëmundjeve, në këtë rast, nga pandemia COVID -19, kur kemi pasur shumë kufizime në lëvizje. Për t'iu menaxhuar më mirë emergjencat e mëdha, duhet pasur angazhim të komunitetit, ku duhet të jenë proaktivë për ta menaxhuar gjendjen e situatës së jashtëzakonshme, duke ju përshtatur edhe mentalitetit të popullatës lokale. Ju si shtet, në ndërtim e sipër, për agjencitë emergjente duhet ta merreni një model që i përshtatet vendit tuaj.

Shemsedin Dreshaj, tha se takimi me prof. Roberto Mugavero, që është drejtues i një organizate shumë të rëndësishme të Këshillit të Evropës, është e mirëseardhur për marrjen e përvojave nga Qendra e Këshillit të Evropës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC). Kërkoj që

të ndahen përvojat nga trajnimet që i ka Qendra e KE-së për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa, për agjencitë tona të emergjencave, duke iu përshtatur rrethanave të vendit tonë, është mirë që niveli Qendres Evropiane për Mjekësi në Emergjencë dhe Katastrofa, që është në kuadër të KE-së, ta ketë një udhërrëfyes për shtetet e vogla, siç është Kosova, që ta keni si modeli funksionimit të kësaj qendre të KE-së.

Mirsad Shkreta, tha se takimi me prof. Roberto Mugavero, për t'i shkëmbyer përvojat e Qendrës Evropiane për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa, që e drejton, është për t'u përshëndetur dhe i mirëseardhur. Foli për përvojën që e ka pasur Kosova përgjatë periudhës me pandeminë COVID-19. Në atë kohë, sa i përket bazës ligjore, si udhërrëfyes e kishim vetëm një kornizë rregullative, ky ishte plani i reagimit kombëtar, i vitit 2010. Ky plan, në përmbajtjen e tij, ishte gjithëpërfshirës, dhe këtu na u paraqit sfida e parë që institucionet e emergjencave, që duhet të merreshin drejtpërdrejt me luftën kundër pandemisë COVID -19, ishin të shpërndara në disa nivele të vendimmarrjes. Këtu u paraqit nevoja për hartimin e një ligji të ri që u miratua shumë shpejt, Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, në territorin e Republikës së Kosovës. Me këtë bazë ligjore ishte më e lehtë marrja e vendimeve në menaxhim të situatës me COVID -19. Fokus i diplomacisë së Kosovës, së pari është anëtarësimi në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe në Këshillin e Evropës, kuptohet dhe në CEMEC.

Admir Duraj, drejtues teknik i projektit Qendra për Studime Parlamentare të Aplikuara nga Fondacioni "HOPES", tha se sa i përket bashkëpunimit me Qendrën Evropiane për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa (CEMEC), lidhur me trajnimet, si dhe shkëmbim të përvojave profesionale, këtë mund ta bëni me nënshkrimin e një marrëveshjeje, me memorandum të bashkëpunimit.

Fatmire Kollçaku, tha se fokusi ynë, si shtet, është që të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian dhe në Këshillin e Evropës. Ne, si shtet i ri, patjetër kemi nevojë në marrjen e përvojave nga shtetet e zhvilluara dhe të ekspertizave të tyre. Në këtë rast, prej profesorit Roberto Mugavero, të fushës për Mjekësinë në Emergjencë dhe Katastrofa, të cilin e falënderoj për prezantimin e aktiviteteve të qendrës që e drejton. Ne kemi mundësi të mësojmë nga vendet tjera, edhe përkundër të gjitha pengesave që kemi me anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Falë bashkëpunimit bilateral që kemi me shumë shtete, mund t'ia dalim. Sot, kemi mundësi që ne si Kosovë të mësojmë për përvojat më të mira të shteteve të BE-së dhe jemi më të gatshëm t'i përballojmë sfidat në menaxhimin e problemeve në situatat e emergjencës dhe katastrofave natyre, pasi që në të ardhmen, mund të ballafaqohemi në forma të ndryshme, çdo ditë, me këto dukuri.

2. Të ndryshme

Për pikën të ndryshme, nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisioni
